

Shoqeria “MADE SERVICE” Shpk

Nipt: L81825015K

Adresa: Rr. “Rrapo Hekali”,

Tirane

Tirane me 11.11.2019

**KONTRATE SHITJE E KUOTAVE TE KAPITALIT
TE SHOQERISE “MADE SERVICE” Shpk**

Ne Tirane, sot me daten 11.11.2019, ditën e Premte, ne, palet e me poshte shenuara:

PALA SHITESE:

– Z. Eldorado Dermo, i datelindjes 12.06.1989, i biri i Hysniut, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. “Mahmut Fortuzi”, i pajisur me karte identiteti nr leternjoftimi 032525993 dhe nr. personal I90612101R, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte do te quhet **Shitesi**.

PALA BLERESE:

– Z. Antonio Malafronte, i datelindjes 17.08.1976, i biri Nicola, lindur ne Itali dhe banues ne Via Lungo Sisto, nr 2790, Sabaudia (LT), Itali, i pajisur me pashaporte Italine me nr. YA4914537, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte do te quhet **Bleresi**.

- Te dy palet, bazuar ne vullnetin e plote dhe te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe vecanerisht neni 73, pika 1, germa ç dhe pika 2, si dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, hartojne kete kontrate shitje te kuotave te kapitalit ne shoqerine tregtare “MADE SERVICE” Shpk.

1. Shitesi:

- Eldorado Demo, me gjeneralitetet e mesiperme, zoterues i 30% i kuotave te kapitalit ne shoqerine “MADE SERVICE” shpk, te regjistruar ne QKB me Nipt **L81825015K**, ne mbeshtetje te vendimit te organit kompetent te kompanise dhe te pasqyruar edhe ne vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise “MADE SERVICE” shpk nr.3 date 11.11.2019, ka vendosur ti shese ortakut tjetër, z. Antonio Malafronte, 30% te kuotave te kapitalit, me vlere totale 600.000 leke, te cilat ky ortak i zoteron ne shoqerine “MADE SERVICE” shpk. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate z. Eldorado Demo zhvishet nga pjesemarrja e tij ne kete shoqeri.



2. Bleresi:

- Antonio Malafronte, eshte dakort me kete blerje dhe e pranon blerjen e mesiperme dhe behet pronar i 1 kuote me vlere 2.000.000 leke ose 100% te kuotave te kapitalit ne shoqerine "MADE SERVICE" shpk.

3. Cmimi i shitjes se ketyre kuotave do te jete 600.000 leke.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga 1 (nje) kuote me vlere prej **2.000.000** leke, shume e percaktuar ne baze te vullnetit te ortakeve te shoqerise.

Ky kapital eshte i ndare ne 1 kuote ne pronesi te nje ortakut dhe pas kryerjes se ketij transaksioni, ortak i vetem i shoqerise eshte:

1. Z. Antonio Malafronte, i datelindjes 17.08.1976, i biri Nicola, lindur ne Itali dhe banues ne Via Lungo Sisto, nr 2790, Sabaudia (LT), Itali, i pajisur me pashaporte Italine me nr. YA4914537, i cili zoteron 100% te kuotave ose 1 kuote me vlere **2.000.000** leke.

Dispozita te fundit.

Ndryshime te tjera nuk ka.

Kjo kontrate per shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise hartohet ne 4 kopje te barabarta dhe nenshkruhet rregullisht nga palet

SHITESI

Eldorado DEMO

Eldorado DEMO



BLERESI

Antonio MALAFRONTI

